



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 05.prot.

Himarë, më 02.04.2025

PROCESVERBAL

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË RADHËS PËR MUAJIN
MARS TË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ZBARDHUR NGA
ORGJINALI , I MBAJTUR SOT MË DATË 02.04.2025 , ORA 12:00
, NË SALLËN “ NEÇO MUKO “ HIMARË.**

Sot më datë 02.04.2025 zhvillohet mbledhja e radhës të Këshillit Bashkiak Himarë për muajin mars , e shtyrë nga data e njofteuar zyrtarisht e cila ishte vendos nga kryesia më datë 28.03.2025. Të ftuar ; kryetari Bashkisë, administratorët e njësive, drejtoritë , kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët:

1.Dhimitër Kapaj , 2 . Lenica Kocani , 3. Timoleo Gërdhuqi, 4. Afrovita Dhimojani, 5. Loreta Isufi , 6. Artan Bala, 7. Mirka Gjiçali, 8. Elisabeta Lamaj, 9. Fuat Mati , 10. Qirjako Mërkuri , 11. Milto Nika, 12. Aleks Llazari, 13. Nikolin Laska, 14. Nertila Husi.15.Miltiadhi Prifti, 16. Thëllëza Kokaveshi , 17. Silva Burbo ,18. Gjergji Iliadhi, 19. Artionil Shirokaj, 20.Thodhori Foto, (mungon me arsy) 21.Maks Vlashi.

Plotësohet Kuorumi këshilltarëve .

Komunikohet këshillit shprehja e ligjshmërisë së vendimeve të mbledhjes së kaluar . (Kryetari Dhimitër Kapaj)

Nga tre vendimet e miratuara nga këshilli nga muaji shkurt, vendimi me nr.10 është kthyer për procedurë nga prefektura , për efekt mosplotësim votash. **Kryetari këshillit:-** ta hedhim në rivotim vendimin nr.10 , datë 03.03.2025 për miratim në parim , për fillimin e bashkëpunimit të shoqërisë EGEU STONE SH.P.K ? **Këshilli :-** po. **Kryetari këshillit :-** Kush është pro, kundër, abstinen?

Miratohet me 14 vota pro vendimi nr.12 “ Për dhënen e miratimit në parim për fillimin e bashkëpunimit me shoqërinë me shoqërinë Egeu stone sh.p.k (6 vota kundër, 0 abstenim)

Pika 1 e rendit të ditës

Për raportin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2024.

Miratohet materiali. Këshilltarja Afrovita Dhimojani, e diskutojmë edhe në mbledhjen e ardhshme.

Pika 2 e rendit të ditës.

Për miratimin e programeve përgatitore të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2026- 2028 dhe kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve .

Sqaron drejtori juridik. Sqaron drejtori financës Laert Mezani.

Këshilltarja Silva Burbo:- në mbledhjen e komisionit kemi bërë një vërejtje te kalendarit i shpenzimeve , të ketë një sqarim më të detajuar për këshilltarët.

Kryetari këshillit :- e hedhim në votim?

Miratohet me 18 vota pro, Thëllëza Kokaveshi kundra, Silva Burbo kundra.

Miratohet vendimi nr.13 “ Për miratimin e programeve përgatitore të shpenzimeve buxhetore dhe kalendarin për programin afatmesëm 2026-2028.

Pika 3 e rendit të ditës.

Për miratimin e buxhetit faktik Bashkia Himarë 2025.

Këshilltari Gjergji Iliadhi si kryetar i komisionit të ekonomisë, financës dhe auditit relaton raportin .

Gjatë shqyrtimit me anëtarët e komisionit kemi dal me disa pika , tek mirëmbajtja e sheshit Himarë , kjo shumë është e pamjaftueshme dhe shkallët në Stefanel.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani: - unë propozoj të hiqet rruga “ Milto Kallushi” dhe kjo vlerë të kalojë në Himarë fshat. Të hiqet rehabilitimi i rrugës bujqësore Lukovë dhe kjo vlerë të kalojë te rruga “ Shën e Premte” .

Sqaron Kryetari Bashkisë

Më dëgjoni me kujdes, nuk ndryshon asgjë, rrugën “ Shën e Premte” kemi marrëveshje për ta realizuar, të dyja propozimet do të realizohen.

Këshilltari Miltiadhi Prifti :- Unë kam marrë pjesë në dëgjesat publike dhe propozoj rruga Shën e Premte , kam sjellë dhe disa kërkesa nga kryesia e fshatit Lukovë , po i lexoj.

Kryetari Bashkisë:- rruga Shën e Premte është e realizuar.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- po bëhen të gjitha rrugët në Lukovë , po për në Borsh çfarë ngelet? Kjo kërkesë bëhet për interesa të njërit apo tjetrit , janë rrugë të brendshme në tokat bujqësore.

Sqaron Kryetari fshatit Lukovë:- Rruja le të bëhet por vetëm të mos cenohet Shën e Premte.

Këshilltari Qirjako Mërkuri :- Janë 30 m rrugë anës së detit të shembura , kërkoi të futet në buxhet, ka dhe një problem në lagjen “ shkallë” .

Kryetari Bashkisë:- kemi një fond të cilin mund ta kalojmë për këtë çështje.

Banor nga fshati Borsh kërkon fjalën.

Kërkoi investime në lagjen tonë pasi nuk është hedhur asnjë investim.

Kryetari Bashkisë:- në Borsh janë hedh investime të rëndësishme.

Këshilltarja Mirka Gjiçali – ka 10 vjet rruga Stefanel , kur fillon , sepse nuk po shikojmë gjë?

Sqaron drejtori Laert Mezani :- segmenti i fundit është pezulluar për shkak të problemeve me zonën , janë duke punuar.

Këshilltarja Elisabeta Lamaj:- nuk pash në buxhet investime për Kuçin.

Kryetari bashkisë:- Janë të miratuara në dhjetor për Kuçin.

Këshilltarja Silva Burbo :- Propozoj që në sallën lartë te stadiumi të restaurimit dhe të zhvillojmë mbledhjet atje.

Sqaron Kryetari Bashkisë:- ne së shpejti do të ndërtojmë sallë të re, të shpenzojmë kot.

Këshilltarja Silva Burbo:- këshilli më parë ka marrë vendim që në tokat bujqësore të mos zihen rrugët.

Kryetari këshillit :- propozoj të na mundësohet një tavolinë e rrumbullakët për këshillin. Po- Kryetari Bashkisë.

Këshilltarja Silva Burbo : - po futemi në sezon dhe gjendja është katastrofike në Himarë me rrugët , pastërtia, kanalet, po futemi në sezonin turistik.

Kryetari bashkisë:- bëhet fjalë për kanalet e ujërave të zeza , ujin e pijshëm, rrugët, të gjitha vlejnë shumë për turizmin, jam në ndjekje të punimeve dhe së shpejti do të përfundojnë punimet , deri në fund të prillit sepse në maj hapet sezoni turistik.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- sa është shuma e muajve tector, nëntor që nul janë futur në buxhet dhe ku janë hedh si shumë?

Sqaron drejtori Laert Mezani :- 360 milion lekë të reja kjo transferohet tek të trashëguarat dhe bëhet pjesë e buxhetit , janë alokuar te projektet në buxhet sepse buxheti ndahet edhe drejtorit e tjera të cilat bëjnë propozime , nuk është vetëm komuniteti që propozon . Diferenca e këtyre janë ato fonde që i kemi shpenzuar sipas kërkesave tuaja.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- Kryetar juve kërkoni të miratojmë një buxhet pa asnjë lloj ndryshimi , në dhjetor miratuam një buxhet sebashku me ndryshime të cilat këtu nuk i shikoj. Ne propozuam rrugën “ Shën e Premte” dhe Himarë Fshat ku shuma është 100 milion lekë , kemi kërkuar rikonstruksion të rrugës së vjetër, ndriçim e të tj. Çfarë kemi kërkuar nul është pasqyruar gjë këtu, ky buxhet nuk përkon me kërkesat tonë , juve ma vini me projektet tuaja, duhet të jemi në unamitet , unë për vete nuk e votoj.

Sqaron kryetari Bashkisë:- është ai buxhet që keni miratuar në dhjetor , janë të gjitha kërkesat tuaja , jo të gjitha se nuk mundemi , por nuk përjashtohet mundësia me alokimin e fondevë në qershori do të investohen , në Stefanel fillojnë punimet, në Cuakua do të fillojnë , në Himarë ka shumë projekte që do të investohen.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:- Sa është vendosur shuma në buxhet përrugën bujqësore në Lukovë ?

Sqaron drejtori Laert Mezani.

Këshilltari Qirjako Mërkuri :- Unë mendoj kjo shumë të kaloj në rrugën shkallë Borsh.

Kryetari këshillit :- si mund të bëjmë këto lëvizje, hiqe Lukovës e çoja Borshit, nuk funksion kështu.

Këshilltari Fuat Mati:- Ne jemi përfaqësues të komuniteteve tona, dhe këto ndarjet nuk janë të mira , ne kemi të ardhura i gjithë Bregu i detit , këto biznese sjellin të ardhura në Himarë dhe gjysma e fitimit të investohen , shëtitorja në Borsh duhet bërë, të bashkohet me lagjen e malësorëve .

Kryetari këshillit :- e hedhim në votim propozimin fondi i rrugës Lukovë të kalojë në lagjen shkallë Borsh , jeni dakort?

Dakort – këshillit.

Propozim tjeter nuk miratohet.

Largohet nga mbledhja A.Dhimojani pasi më parë kërkoi një pushim prej 10 min për të diskutuar grupet e lëshimit rreth buxhetit.

Këshilltari Milto Nika:- punonjësit e bashkisë të mos i transferojnë nga viti në vit projektet por të zbatohen.Bashkia e Himarës të marr model nga bashkit e tjera, e kam vërejtje këtë. Po shikoj që investohet e harxhohet për festivale, aty në Palermo, mblidhemi të dëgjojmë një violinë, këto fonde të kalojnë në bujqësi , e çështje të tjera më me rëndësi. I bashkohet mbledhjes A. Dhimojani.

Kryetari këshillit :- e hedhim në votim buxhetin?

Miratohet buxheti faktik i bashkisë Himarë për vitin 2025 me nr. Vendimi 14 , me 15 vota pro, pesë kundër (Thëllëza Kokaveshi, Lenica Kocani, Timoleo Gërdhuqi, Afrovita Dhimojani, Silva Burbo)

Pika 4 e rendit të ditës

Informacion nga këshilli bashkiak për veprimtarinë e tij për vitin 2024.

Miratohet materiali . Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- e lëmë diskutim për mbledhjen e radhës.

Pika 5 e rendit të ditës.

Miratohet ndihma ekonomike nga 6% për periudhën 1- 28 shkurt me nr.vendimi 15.

Pro të gjithë këshilltarët.

Pika 6 e rendit të ditës

Për miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Himarë.

Kryetari këshillit : -kush ka pyetje, diskutime? Sqaron drejtori financës.

Këshilltarja Silva Burbo :- te tabelat në fund për etikën që është për komunitetin , tek plani veprimit që është për 2028 këto me ngjyrë të kuqe si mund të rregullohen , si do të punoni lidhur me këtë ? Prej 12 gushtit ndryshimi i nivelit të pagave , është një faktorë që do të nxitë të rinjtë të mos largohem nga vendi , të rinjtë në Himarë do ti nxiste të punojnë në administratë , vendet vakante publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë.

Këshilltarja- A bëhen trajnime profesionale? Po, pasi marrin statusin, drejtori.

Këshilltarja:- A ka konflikt interesit në bashki, ? Jo – drejtori, bëhet publikimi i auditimit, auditimi i jashtëm bëhet nga KLSH dhe ai i brendshëm i sillet këshillit.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- tek pjesa e auditimit dmth bëhet çdo vit dhe nga ky kanë ardhë edhe prioritetet? Drejtori :- te plani veprimt kemi përcaktuar të gjitha problematikat .

Autokritika nëjenë në bashkëpunim dhe në bashkëveprim – Këshilltarja.

Kryetari këshillit :- jeni dakort ta hedhim në votim? Sa janë pro, kundër, abstenim?

Miratohet vendimi nr.16 për planin e integritetit për bashkinë Himarë me 19 vita pro , Silva Burbo kundër (1)

Pika 7 e rendit të ditës

Për miratimin e rregullores për hapësirat publike me pagesë në Bashkinë Himarë.

Sqaron drejtori Laert Mezan : - është një rregullore që përcakton formën dhe elementet organizmatik , po të shikosh Lukovën që ishte problematike kemi një formë me ngjyrat .

Këshilltarja Thëllëza Kokaveshi :- për kioskat si do të funksionojë , si do të jepen, do të mbingarkesës Himara? Ka rregullore strikte nga largësia e tyre , çfarë distance është parashikuar?

Sqaron Kryetari Bashkisë :- shumë e drejtë pyetja juaj, në pjesën e himarës nuk duhet të ketë, vetëm te shëtitorja.

Kryetari këshillit :- e hedhim në votim? Sa janë pro, kundra, abstenim?

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- e falenderoj kush e ka përpiluar dhe të shikohet me përparësi, çdo kërkesë të shqyrtohet dhe jam dakort për çfarë foli kryetari Bashkisë

Këshilltarja : Afrovita Dhimojani :- të ketë kujdes bashkia të mos cenohen bizneset egzistente . Sqaron Kryetari Bashkisë, nuk preken bizneset ekzistonte, sivjet menduan te sheshi përballë omonies të çojmë tavolina për operatorët turistik , ditarët, në këtë kuadrat .

Kryetari fshatit Borsh:-kërkoi hapsirë tokë për varrezat e fshatit Borsh.

Kryetari Bashkisë :- e kemi planifikuar .

Këshilltarja Loreta Isufi :- është vendosur nivel gjobash për hapësirat publike? Po- drejtori.

Kryetari këshillit :- e hedhim në votim?

Miratohet vendimi nr 17 “ Për rregulloren e hapsira publike me pagesë në bashkinë Himarë”, me 19 vota pro, 1 kundër.

Pika 8 e rendit të ditës.

Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë (për ndërmarrjen e re të shërbimeve)

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- nga çfarë konstatova unë keni keni përcaktuar edhe buxhetin , dhe këtë ndryshim e keni kërkuar për drejtorinë e ndërmarrjes , sepse ne nivelin e pagave e kemi miratuar më parë , juve na sillni ndryshim pagash vetëm për drejtorin , sepse tabela është e njëjtë me dhjetorin që e kemi miratuar, pra rrissni rrogat edhe të specialistëve jo vetëm të drejtorive.

Kryetari Bashkisë:-Rrogat kanë pësuar rritje sipas kategorive pa përjashtim , ka patur lapsus të administratës që nga dhjetori që kaloi , po barazojmë rrogat e NShP me administratën e bashkisë .

Këshilltarja Thëllëza Kokaveshi :- Do të kompensohet për punonjësit rroga për ata që si kanë marrë që nga vendi që hyri në fuqi?

Kryetari – e kemi menduar ta bëjmë me shpërbirim.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- këto shtesa janë parashikuar në buxhet ?

Po- kryetari.

Kryetari këshillit :- jeni dakort ta miratojmë ?

Miratohet niveli i pagave për ndërmarrjen e re NSHP me nr vendimi 18 me 19 vota pro, 1 kundër (A. Dh.)

Pika 9 e rendit të ditës

Për miratimin e rregullores për parkimet publike me pagesë në Bashkinë Himarë.

Këshilltarja Thëllëza Kokaveshi :- a nuk është për konsultim publik kjo rregullore ?

Kryetari Bashkisë:- jo.

Këshilltari Gjergji Iliadhi :- si do të procedohet me pagesën për këto parkimet? Kryetari :- sipas rregullores.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:- ta lëmë për 6 muaj dhe e vendosim si këshill shumën , pagesën

Këshilltarja Silva Burbo :- Për sqarim të komunitetit parkimin e rezervuar kush ka të drejtë? Sqaron drejtori Laert Mezani :- janë kë dobi të biznesit , për qëllimin ngarkim – shkarkim është i parapaguar që mund ta rezervoje.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- rregullorja nuk është shumë e saktë, kjo tarifë mund të jetë e ndryshueshme , për personat me aftësi të kufizuar kanë tarifë të reduktuar , natën për disa zona parkimet janë falas , në këtë rregullore ka paqartësi kryetar , kërkon sqarim më të detajuar .

Kryetari Bashkisë :- vendet që janë përcaktuar për pagesë janë të caktuara, rezidenti nuk paguan sepse ka kartën , para shtëpisë edhe pse është hapsirë publike nuk ka gjobë , pagesat do të bëhen me kartë , biletat të parapaguar.

Kryetari këshillit :- jeni dakort ta hedhim në votim .

Miratohet materiali për miratimin e rregullores për parkimet publike me pagesë në Bashkinë Himarë me nr. Vendimi 19 me 19 vota pro, 1 kundër (A.Dh)

Pika 10 e rendit të ditës

Për dhënen në parim për shfrytëzim të ish shkollës 8- vjeçare Vuno në administrimin e Ministrisë së kulturës dhe inovacionit .

Këshilltarja Thëllëza Kokaveshi :- Ky material është eér konsultim publik dhe është në administrim të Bashkisë Himarë , nuk e kuptoj pse duhet ta japim ?

Kryetari Bashkisë:- ne nuk kemi fonde, është një marrëveshje me Arbëreshët e Italisë dhe ministrisë së kulturës për bashkëpunim , kjo kërkesë ka ardhë pa qënë unë këtu, ajo shkollë është gjermadh , tashmë e rrënuar , pse mos ta miratojmë , ne e japim në parim dhe projektim e bënë ministria e kulturës.

Kryetari këshillit :- le t'i japim , sepse po të shikosh ish shkollat dhe në njësinë Horë – Vranisht po rrënohen.

Këshilltari Fuat Mati :- unë propozoj të miratohet sepse ka qëllim kombëtar , vetëm të mos tjetërsohet kjo pronë .

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- që projekti të ketë efekt shikohet baza ligjore , shkolla është në pronë të Bashkisë Himarë , baza ligjore e përcakton qartë dhe thotë do të kalojë në pronësi të min së kulturës, qëllimi është të jepet në pronësi , propozojmë :- të bëhet muze por jo t'i kalojë min së kulturës si pronë .

Kryetari Bashkisë:- është në administrim jo në pronësi.

Kryetari këshillit :- e hedhim në votim ? Sa janë pro, kundër, abstenim?

Miratohet vendimi nr.20 “ Për dhënen e ish shkollës 8- vjeçare Vuno në administrim ministrisë së kulturës dhe inovacionit me 18 vota pro, 2 kundër (Thëllëza Kokaveshi , Silva Burbo)

Të ndryshme

Kryetari këshillit lexon kërkesën e shoqërisë Sokeil Sea , kërkesë e cila duhet të merret në shqyrtim nga drejtoria përkatëse.

Kërkesë e një Banori Dhërmë.

Të dyja kërkesat ngelen për tu shqyrtuar në mbledhjen e ardhshme. Kryetari këshillit mbyll mbledhjen dhe firmos procesverbalin e mbajtur gjatë mbledhjes nga sekretari këshillit.

Sekretari

Elena Memushaj

